



REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIJA PROTIV KORUPCIONIT ANTICORRUPTION AGENCY	
Priloge Dok. / DMP	Priloge 03-4338/12
Numeri 02	Data 09.12.2012
PRISHTINE	



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN**

Nr.12792/11

**GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE PRIZREN**, me gjykatesen Vjollca Buzhalen me procesmbajtesen Firdes Santurin, ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurit Adem Kafexholli nga Suhareka , per shkak te kundevajtjes nga neni 16 par.1 p.1 lidhur me nenin 6 dhe nenin 3 te Ligjit nr. 03/L-151, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte publik , ne baze te nenit 195 te LMK-se me 08.10.2012 mori kete

**A K T V E N D I M**

I pandehuri Adem Kafexholli nga I ati Sefer I lindur 1955 në fsh. Bellanicë tani jeton në Suhareke ruga Brigada nr. 123 nr. 12, me kombesi shqiptar, I martuar baba I tre femijeve, ka te kryer fakultetin e mjeksise, I gjendjes se mesme, ekonomike.

**Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S**

Sepse I pandehuri nuk ka bere deklarimin e pasurise ne afatin e regullte ligjor deri me dt. 31.03.2011 , deklarim I cili I obligon te gjithë zyrtaret e larte publik që për pasurinë e tyre të deklarohen regullisht për qdo vit ,sipas kerkeses se AKK – nuk ka permbushur këtë obligimin ligjor mbrenda afatit .

-me te cilin veprim ka kryer kundervajtjen nga neni 16 par.1 p.1 lidhur me nenin 6 dhe nenin 3 te Ligjit nr. 03/L-151, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte publik se e per kete

**Q O R T I M I**

**A r s y e t I m**

Sipas kerkeses se Agjensionit antikorupcion ne Prishtine me nr.01-3241/11 të dt. 12.07.2012 është ngritur procedura kundervajtese ndaj te pandehurit Adem Kafexholli nga Suhareka per shkak te kundervajtjes nga neni I lartecekur.

Gjendja faktike e pershkruar me persefermi si ne dispozitiv te ketij aktvendimi eshte vertetuar permes deklarates se pranimit te te pandehurit I cili pos tjerash theksoi : Unë në cilësinë e kryeshefit të Departamentit „Nena dhe femijë„ në kuader të spitalit Rajonal të Prizrenit e ushroj këtë detyre perafesisht që 8-9 vite, dhe lidhur me plotesimin e formularit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë në cilësinë e zyrtarit të lartë public për Agjencionin antikorupcion konstatoi se për asnjë vit nuk na është kërkuar deklarimi I pasurisë me shkrim nga ana e Ministrisë së shëndetsisë, andaj në momentin kur na kemi qenë të informuar dhe atë verbalisht menjëherë e kam plotësuar një formulë të tillë . Inicimin e procedurës kundër meje nga ana e Agjencionit antikorupcion e konsideroj në kuader të ligjit mirepo kjo është leshim I bere nga hijerahija në kuader të Spitalit Rajonal të Prizrenit . Gjithashtu du atë theksoj se unë deklarimin e pasurisë vazhdimisht e deklaroj në formularin e bashkeshortës sime Lirije Kafexholli e cila është gjyqtare në gjykatën Komonale për Kundervajtje në Suharekë, dhe kam menduar se nuk kam nevojë për një deklaram tjetër . Kërkoj falje para jush dhe besoj se do të mireni parasysh rrethanat e lartecëkura më lartë , si prova materijale gjykates ia prezentoj vertetimin që kam deklaruar me vonë por jo me fajin tim por pse nuk kam qenë I informuar më kohe., andaj gjykata ishte I mendimit që të pandehurit tija shqiptoi qortimin konform nenit 10 të KM\_ së, me bindje se edhe me një shqiptim të tillë do të arihet qëllimi I ndeshkimit.


Gjate caktimit të denimit janë vlerësuar rrethanat nën të cilat është kryer kundervajtja, pesha e kundervajtjes së kryer dhe pasojat e saja, shkalla e përgjegjësisë, si dhe rrethanat materijale të pandehurit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të ketij aktvendimi.

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË PRIZREN**  
Nr.12792/2011

te dt.08.10.2012

Procesmbajtësja  
Firdeze Santuri



Gjykatesi për kundervajtje  
Vjollea Buzhala

Vjollea Buzhala

**UDHEZIMI JURIDIK** Kunder ketij aktvendimi e në afat prej 8 ditësh mund të ushtrohet ankese Gjykatese së lartë për Kundervajtje në Prishtinë, përmes kesaj gjykate pa taksa.